



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 832/4 prot.

Tiranë më 27.7.2021

VENDIM

Nr. 33, datë 27.7.2021

PËR KONTROLLUESIN “IRIS TRADE” SHPK (SHOPMANIA.COM.AL)

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Iris Trade” SHPK (ShopMania.com.al).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 79, datë 31.05.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit “Iris Trade” SHPK (ShopMania.com.al) (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetase në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi është një shoqëri tregtare me veprimtari të gjerë, e cila vepron edhe në fushën e tregtisë online (e-commerce) nëpërmjet faqes “www.shopmania.com.al”.

Në kuadër të trajtimit të ankesës së subjektit të të dhënave B A, rezulton se në numrin e ankuesit janë dërguar mesazhe promovionale lidhur me produktet e reklamuar për shitje në faqen www.shopmania.com.al, nga numri .
Nga verifikimi i kryer nuk u provua që numri , nga i cili i kanë vajtur

mesazhet promociionale ankuesit të jetë në përdorim të Kontrolluesit. Numrat të cilat janë në përdorim të Kontrolluesit për qëllime promociionale janë 069xxxxxxx, 069xxxxxxx, (numra të cilët gjenden në faqen www.shopmania.com.al) si dhe numri 069xxxxxxx.

2. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit, Zyra e Komisionerit konstatoi se Kontrolluesi kryen fushata promociionale nëpërmjet platformave sociale si “Facebook” dhe “Instagram”, si dhe dërgon oferta promociionale nëpërmjet mesazheve të shkruara (sms-ve) pa marrë paraprakisht pëlqimin e subjekteve të të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tyre për qëllime marketingu, pavarësisht mënyrës së sigurimit të të dhënave të tyre, është në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë së përpunimit të sanksionuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 5 dhe me kriteret ligjore të përpunimit të sanksionuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit.

3. Në faqen e internetit të Kontrolluesit www.shopmania.com.al subjektet e të dhënave (klientë) mund të krijojnë llogari duke paraqitur të dhënat e tyre, por nuk është i mundur ç’regjistrimi i kësaj llogarie nëse subjekti i të dhënave dëshiron të tërheqë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij, në kundërshtim me parashikimet në nenin 6 të Ligjit dhe në Udhëzimin nr. 16, datë 23.12.2012 të Komisionerit për “Mbrotjtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 16”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrolluesi ose përpunuesi, që merret me përpunimin e të dhënave personale, me qëllim ofrimin e shërbimeve, duhet t’i japë mundësinë subjektit që ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij për të revokuar këtë pëlqim në çdo kohë. Kontrolluesi nuk mund të vazhdojë përpunimin nëse subjekti i të dhënave ka shprehur mospajtimin ose ka kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre.

Për sa kohë kontrolluesi nuk jep mundësinë që subjekti i të dhënave të tërheqë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm.

4. Kontrolluesi ka publikuar “Politikat e Privatësisë” në faqen www.shopmania.com.al. por nga shqyrtimi i tyre rezulton se subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e Privatësisë”, nëpërmjet të cilave të informojë plotësisht subjektet e të dhënave mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezulton se nuk është përmbushur detyrimi për njoftim në kundërshtim me parashikimin në nenin 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

6. Kontrolluesi ka nënshkruar kontratë shërbimi me shoqërinë “TNT Express Albania” SHPK, me objekt transportin postar të produkteve. Palët kanë nënshkruar marrëveshje konfidencialiteti, por konstatohet se në marrëveshje nuk janë përfshirë detyrimet ligjore sipas parashikimit në nenin 20 të ligjit si dhe në Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr.19.

Në përfundim të hetimit administrativ, në datën 06.07.2021, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga Kontrolluesi me pretendimin “U njoha me procesverbalin dhe pretendimet e mia do ti paraqes me shkrim ose në seancë dëgjimore”.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të “Kodit të Procedurave Administrative”, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 15.07.2021, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit. Kontrolluesi nuk mori pjesë në seancën dëgjimore dhe nuk paraqiti pretendime me shkrim lidhur me shkeljet administrative të evidentuara gjatë kontrollit.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të nenit 39, pika 1, germat “a”, “b”, “ç” dhe “d” të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, sipas përcaktimit në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysht faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 29, 30, 39 (pika 1, germat “a”, “b”, “ç” dhe “d”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje të vazhdueshme përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;

5. Kontrolluesi duhet të ndalojë menjëherë formën e aplikuar për mbledhjen e numrave të telefonit që përdor për qëllim marketingu të drejtpërdrejtë;
6. Në vijim të detyrimit të parashikuar në pikën 5, të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat e mbledhura nga subjektet e të dhënave (numrat e telefonit për qëllim marketingu që janë siguruar nga faqet online), të cilat përpunohen në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;
7. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë, etj;
8. Kontrolluesi, të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit përkatës detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19;
9. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimet e parashikuara në pikat 5 dhe 6;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 7 dhe 8Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
10. Kontrolluesi të njoftojë Zyren e Komisionerit për masat e marra.
11. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
12. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 24.07.2021.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

